



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**  
**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më .\_\_\_\_.10.2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës të paraqitur nga z. Q.Q

E-mail : \_\_\_\_\_

Cel : \_\_\_\_\_

I nderuar z. Q.,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 1775 prot datë 17.10.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të nenit 3 dhe 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nenit 20 dhe nenit 39 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit” i ndryshuar, kërkohet njohja dhe disponimi materialisht si më poshtë :

- Kërkesat e paraqitura në institucion lidhur me kandidatin Q.Q. nga ana e MEPJ dhe përgjigjet e Autoritetit;
- Dokumentet që provojnë gjetjet (kërkesë e bazuar në nenin 18 të ligjit nr 45/2025);
- Të gjithë praktikën e ndjekur nga Autoriteti për shtetasin, ju informojmë se :

Në zbatim të kuadrit ligjor për informacionin e klasifikuar, duke qenë se kërkesa e ardhur për verifikimin e kandidatit Q.Q., ishte me nivel klasifikimi, u trajtua si e tillë deri në mbylljen e saj me vendimmarrje dhe përcjelljen nga Autoriteti tek institucionet, me të njëjtin nivel dhe të njëjtin afat ruajtjeje me informacionin e ardhur.

Niveli i klasifikimit të informacionit dhe mungesa e Certifikatës së Sigurisë së Personelit, janë pengesa ligjore të cilat nuk lejojnë njohjen me aktet e nxjerra në emrin tuaj.

Sipas ligjit nr. 10/2013 “Për informacionin e klasifikuar” “E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar është i klasifikuar, referuar pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” që parashikon “Autoriteti publik duhet të fillojë menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, në përputhje me kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar”.

Në mbështetje të sa më sipër, nga ana e Autoritetit është kërkuar bashkëpunimi me institucionin e origjinës së informacionit të klasifikuar, për të vijuar me hapat e mëtejshëm.

Gjithashtu informojmë se në zbatim të nenit 17 pika 5 të ligjit nr. 119/2014, është e nevojshme shtyrja e afatit për dhënien e informacionit me 30 ditë pune.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave**

**Sofi Noti**